



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, par. 1.5 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 20, par. 11 të Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 52, shkronja h të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, dhe të kërkesës së Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2017, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), pa procedurë konkurrimi.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: parcela kadastrale nr. 636-0, Zona Kadastrale Çagllavicë, me kulturë "rrugë", nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10108 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 15 m², e evidentuar si "pasuri shoqërore - Kuvendi Komunal Prishtinë".
- III. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është në kohëzgjatje për 15 vjet.
- IV. Prona e paluajtshme e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- V. Kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për raste të veçanta, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe nga përfaqësuesi i subjektit të cekur në pikën I të këtij vendimi.
- VI. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale për raste të veçanta, evidentohet në regjistrin e të drejtave pronësore.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 463/01-0182496/17 , më 26.07.2017.



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dpl.